



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 21.18.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË  
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME PËR VITIN E  
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Florë Berisha - Udhëheqëse ekipi, Riza Spanca dhe Hysen Restelica- Anëtar ekipi, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit- Arvita Zyferi.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	5
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	15
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	24
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	25
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....	28
Shtojca IV: Letërkonfirmimi .....	33

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 19 nëntor 2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Pasqyrat vjetore financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale.

Megjithatë ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se ende kishin mbetur pa u mbyllur shpenzimet për mallra e shërbime të realizuara nga Misionet Diplommatike të Kosovës në vlerë prej 230,718€, si dhe nuk ishin regjistruar pasuritë në vlerë 185,446€ në sistemet elektronike përkatëse.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi në pjesën 1.1 të raportit.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**

MPJ ende nuk kishte aprovuar shpenzimet për mallra dhe shërbime të realizuara nga MDK-të, të ndodhura në vitet paraprake. Megjithëse, në vitin 2016 nuk kishte shpenzime të pa aprovuara. Poashtu pasuria e blerë gjatë vitit nuk ishte regjistruar në regjistrat përkatës dhe kjo ka ndikuar në nënvlerësimin e pasurisë në PFV.



Ministri duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë mangësive të cilat kanë shkaktuar theksimin e çështjes në këtë raport dhe të bëjë përpjekje për eliminimin e tyre në vitet e ardhshme (Shih çështjen në nënkapitullin 1.1).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me planifikimin strategjik, menaxhimin e rrezikut, funksionimin e fushës së auditimit të brendshëm dhe zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak janë të dobëta dhe kërkojnë një fokus më të madh.



Ministri duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë duke ndikuar në avancimin e proceseve që ndërlidhen me përgatitjet e planit strategjik të ministrisë, hartimin e regjistrat të rreziqeve, zbatimin e planit të veprimit si dhe formimin e një Komiteti të Auditimit në periudhë sa më të shpejtë kohore (Shih çështjet në kapitullin 2).

Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive - ekzistojnë dobësi në disa sisteme të rëndësishme të menaxhimit financiar duke përfshirë mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe menaxhimin e pasurisë.



Ministri duhet të sigurojë se janë marrë parasysh rekomandimet tona në këto fusha dhe janë forcuar dukshëm kontrollet për eliminimin e problemeve të njëjta në vitet në vijim (Shih çështjet në kapitullin 3).

**Përgjigja e Menaxhmentit të MPJ-së - auditimi 2016**

Menaxhmenti i MPJ-së ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

## 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

**Hyrje**

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e

marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### **Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes**

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

### **Baza për opinion**

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

---

## Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për çështjet e mëposhtme:

- MPJ ende nuk i ka aprovuar shpenzimet e mbetura për mallra dhe shërbime të realizuara nga MDK-të në vlerë prej 230,718€, të cilat ishin rezultat i gabimeve, kursit të këmbimit, mos-regjistrimit të shpenzimeve, shpenzimeve të pa lejuara me rregullore dhe depozitave të paregjistruara. Të gjitha shpenzimet e paaprovuara i përkasin periudhës 2008 - 2015, derisa në vitin 2016 gjendja është përmirësuar dukshëm.
- Pasuria e paprekshme (softuerë) në vlerë prej 128,532€ lidhur me projektin "Krijimi dhe vendosja e sistemit të vizave", si dhe pasuritë tjera të blera gjatë vitit në vlerë totale 56,914€ nuk ishin të regjistruara në sistemet elektronike për menaxhimin të pasurisë. Si rrjedhojë, pasuria e prezantuar në raportin vjetor financiar 2016 ishte e nënvlerësuar.

## Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të

---

auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MPJ kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013 për shpenzimin e parave publike;
- Rregulla Financiare 03/2010 për Të hyrat vetanake;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet tremujore, përfshirë pasqyrat nëntëmujore;
- Raportet për obligimet e papaguara;
- Plani fillestar dhe final i prokurimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Fillimisht PFV-të e MPJ-së përmbanin gabime, mirëpo ato ishin korrigjuar në fund të muajit mars 2017, andaj ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale. Gabimet e identifikuara të theksimi i çështjes nuk e modifikojnë opinionin e auditimit.

Në kuadër të raportimit të jashtëm vërejtëm se MPJ kishte arritur t'i përmbushë të gjitha obligimet ligjore, me përjashtim të barazimeve mujore me të hyrat në thesar. Sipas rregullës financiare 03/2010 për të hyrat kërkohet të bëhen barazime mujore me thesarin, mirëpo MPJ kishte bërë vetëm barazime tremujore.



## 1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

- Rekomandimi 1** Ministri duhet të sigurojë se janë marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuara në Theksimin e Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar problemet lidhur me shpenzimet e paaprovuara të bartura nga vitet e kaluara, të cilat janë duke shkaktuar problem sistematik për MPJ-në; dhe
- Rekomandimi 2** Ministri duhet të forcojë kontrollet lidhur me obligimet ligjore për raportimin e të hyrave dhe barazimin mujor të tyre me thesarin me qëllim që të plotësohen kërkesat statutores.

## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MPJ-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga MPJ siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MPJ-së veçanërisht në lidhje me moszbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak, kujdesit jo të mjaftueshëm ndaj procesit të vet-vlerësimit, anashkalimin e procesit të menaxhimit të rrezikut, mungesa e strategjisë, si dhe mungesa e komitetit të auditimit duke pamundësuar rritjen e efikasitetit të kontrolleve të brendshme.

---

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të MPJ-së ka rezultuar në 19 rekomandime kryesore. MPJ kishte përgatitur një Plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet, megjithatë niveli i zbatimit nuk ishte i kënaqshëm.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, nga gjithsej 19 rekomandimet e dhëna në vitin paraprak, vetëm tri (3) prej tyre ishin zbatuar, tetë (8) ishin në proces, ndërsa tetë (8) prej tyre kishin mbetur të pa zbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

---

### Çështja 3 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- E gjetura** Edhe pse MPJ ka zbatuar kërkesat për të hartuar një plan veprimi brenda afatit kohor, kjo nuk është mbështetur me një monitorim formal të zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP). Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim të identifikohen dhe adresohen. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësim të vazhdueshëm në të gjithë organizatën.
- Rreziku** Mungesa e monitorimit të afërt dhe zbatimit të rekomandimeve, rrit rrezikun që mangësitë e njëjta të paraqiten edhe në periudhat tjera. Kjo ndikon në menaxhim jo kualitativ të të hyrave dhe shpenzimeve të parasë publike.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet në mënyrë sistematike nga menaxhmenti për të siguruar zbatimin e rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara.

## 2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për auditimin e MPJ-së, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuar në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MPJ-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

### Çështja 4 – Pyetësi i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë

**E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë (5) komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga MPJ ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. Kjo kishte ndodhur për shkak se MPJ ende nuk kishte iniciuar ndonjë proces formal për hartimin e regjistrit të rreziqeve. Për më tepër, stafi ende nuk e kishte kuptuar rëndësinë e zbatimit të kësaj kërkesë ligjore; dhe
2. Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) nuk konsiderohen si të vendosura, sepse MPJ nuk kishte të hartuar strategjinë e cila do të ishte një udhërrëfyes për një monitorim efektiv të përmbushjes së objektivave.

**Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes si dhe mungesa e strategjisë së organizatës mund të ndikojnë në dobësimin e proceseve operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët. Më tutje, mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të reduktojë cilësinë e aktiviteteve të realizuara, për shkak të mos ndërmarrjes së veprimeve parandaluese në kohë për të evituar ndikimin e tyre.

**Rekomandimi 4** Ministri duhet të sigurojë se është kuptuar qartë rëndësia e hartimit të strategjisë së organizatës, si dhe hartimi i regjistrit të rrezikut nga personat e kyçur në proces. Në këtë mënyrë MPJ do të mund të monitorojë dhe të ndërmerr veprime në kohën e duhur në rastet e paraqitjes së pengesave gjatë realizimit të objektivave të saj.

## 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MPJ operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

### 2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Nga rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në këtë fushë, mund të konkludojmë se menaxhmenti ka vendosur një strukturë organizative adekuate, kishte bërë delegimin e detyrave dhe përgjegjësive dhe ishte informuar për proceset e zhvilluara në kuadër të ministrisë.

Departamentet dhe divizionet përgatitin raporte të rregullta në drejtim të Sekretarit të Përgjithshëm, i cili po ashtu organizon takime pune të rregullta me udhëheqësit e njësive.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është një pjesë kyçe e sistemit të kontrollit të brendshëm. Ne marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit (KA). Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe KA.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) gjatë vitit 2016 ka funksionuar me tre (3) auditor përfshirë edhe Drejtorin e njësisë.

NjAB ka hartuar planin strategjik të auditimit të brendshëm për periudhën 2015-2017, ku ishin paraparë objektivat strategjike. Me tutje, plani vjetor ishte mbështetur në planin strategjik dhe ishte hartuar në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve të tyre. Në planin vjetor NjAB kishte planifikuar katër (4) auditime dhe një (1) auditim me kërkesë (ad hoc). Në planin e auditimit janë përfshirë fushat si: Mallra dhe shërbime, Paga dhe mëditje, Procedurat e prokurimit, si dhe Menaxhimi i depos.

Për periudhën janar-dhjetor 2016, NjAB kishte realizuar në tërësi planin e saj, duke përfunduar katër (4) raporte ku janë dhënë rekomandime të cilat ishin të rëndësishme për përmirësimin e procedurave të menaxhimit financiar.

Megjithatë, KA nuk kishte funksionuar, andaj nuk ishin shqyrtuar raportet e NjAB-së përkatësisht mënyra e zbatimit të rekomandimeve të tyre.

---

### Çështja 5 - Mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit - Prioriteti i lartë

**E gjetura** UA 11/2010 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit të brendshëm neni 5, specifikon se KA duhet të mbajë së paku katër (4) takime gjatë vitit. Deri më 06.06.2016 kishte qenë në fuqi KA, megjithatë ata nuk kishin mbajtur asnjë takim për të diskutuar rreth proceseve të cilat ndërlidheshin me auditim të brendshëm. Edhe pasi kishte skaduar mandati i tyre nuk ishte vërejtur ky detaj dhe si rezultat nuk ishte formuar KA i ri, gjë që kishte ndikuar që mos të shqyrtohen raportet gjatë këtij viti.

**Rreziku** Mosfunksionimi i KA-së zbeh dukshëm punën dhe vlerën e auditimit të brendshëm, përfshirë gjithë procesin nga planifikimi e deri të raportimi, dhe zbatimi i rekomandimeve. Për me tepër në mungesë të KA-së ekziston rreziku i varësisë së NjAB-së nga menaxhmenti.

**Rekomandimi 5** Ministri duhet të sigurojë që në afat sa më të shkurtë të themeloj dhe funksionalizojë KA-në. Duke emëruar një komitet kompetent të auditimit do të ngritej vlera e auditimit të brendshëm dhe do të sigurohej një funksion i mirëfilltë në zingjirin e sistemit të kontroleve të brendshme.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MPJ në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces relativisht të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Megjithatë, një numër i proceseve të MFK-së duhet të përmirësohen edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të Ministrisë.

Procesi buxhetor është menaxhuar mirë, me një përqindje të realizimit prej 96%. Si rezultat i hapjes së Misioneve Diplomatike të Kosovës (MDK) të reja, në MPJ kishte rritje të dukshme të të hyrave në raport me vitin e kaluar. Po ashtu procedurat e prokurimit ishin menaxhuar në mënyrë efektive.

Edhe përkundër përmirësimeve në fushat e lartcekura, veprime shtesë nevojiten në procedimin e lëndëve për pagesë dhe në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë. Mangësi janë hasur edhe në fushën e subvencioneve.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
<b>Të hyrat vetjake</b>	<b>2,546,086</b>	<b>1,838,477</b>	<b>1,629,568</b>

Në vitin 2016, MPJ ka arkëtuar 707,609€ të hyra më shumë se në vitin paraprak. Arkëtimi i të hyrave bëhet nga MDK që i pajisin qytetarët e Kosovës në diasporë me dokumente të ndryshme si dhe nga lëshimi i vizave. Rritja e të hyrave ishte rezultat i hapjes së MDK-ve të reja në vitin 2016.

**Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>19,059,429</b>	<b>19,824,809</b>	<b>19,213,681</b>	<b>18,243,748</b>	<b>18,336,576</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	19,059,429	19,755,262	19,183,401	18,200,658	17,051,498
Grantet e Donatorëve	0	69,547	30,280	43,090	1,285,078

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 765,380€. Kjo rritje ishte bërë pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë. Në vitin 2016, MPJ ka përdorur 96% të buxhet final. Përqindje e ngjashme e realizimit ishte edhe vitin e kaluar.

**Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>19,059,429</b>	<b>19,824,809</b>	<b>19,213,681</b>	<b>18,243,748</b>	<b>18,336,577</b>
Pagat dhe Mëditjet	5,261,267	5,768,977	5,759,871	5,046,204	4,798,956
Mallrat dhe Shërbimet	12,403,547	12,684,559	12,088,464	12,446,918	12,582,038
Shërbimet komunale	538,051	385,507	380,578	354,966	391,310
Subvencionet dhe Transferet	100,000	364,547	364,470	98,029	64,500
Investimet Kapitale	756,564	621,220	620,298	297,631	499,773

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave



---

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Me rishikim të buxhetit kategoria e pagave dhe mëditje kishte rritje prej €507,710. Kjo rritje ka ndodhur për shkak të rritjes së numrit të zyrtarëve në misione diplomatike ku me ligj të buxhetit numri i punëtorëve në misione diplomatike ishte 127, ndërsa numri aktual 139.
- Me vendim të Qeverisë 02/114 kategoria mallra dhe shërbime kishte një rritje në vlerë prej 270,000€ si rezultat i kërkesës së MPJ-së për shlyerjen e obligimeve për shërbime lobimi dhe konsulente. Rritja në vlerë prej 60,469€ ishte rezultat i rritjes së granteve nga donatorët si dhe 542€ ishin transferuar në këtë kategori nga nënkategoria e shpenzimeve komunale. Më pas me rishikim të buxhetit kjo kategori ishte reduktuar për 50,000€.
- Shuma prej 596,095€ në kategorinë mallra dhe shërbime në fund vit kishte mbetur e pashpenzuar dhe kjo kishte ndodhur si rezultat problemeve me SIMFK-në për shkak të bllokimit të sistemit dhe pamundësisë së procedimit të pagesave.
- Kategoria e shërbimeve komunale me rishikim të buxhetit dhe me disa transfere nëpër kategoritë tjera ishte zvogëluar për 152,544€;
- Rritja e buxhetit për subvencione dhe transfere ishte në vlerë 264,547€. Rritja prej 200,000€ është rezultat i subvencionimit për organizimin e kryer në 'Kanonizimin dhe shpalljen e Shenjtërisë së Nënës Terezë', ndërsa rritjet prej 9,077€ dhe 55,470€ ishin rezultat i granteve nga donatorët dhe transfereve nga kategoritë tjera (komunali dhe kapitale).
- Kategoria Investime kapitale ishte reduktuar në vlerën prej 135,344€ si rezultat i vendimeve qeveritare për kursime buxhetore dhe për shkak të disa transfereve të brendshme të cilat ishin mbështetur me vendime përkatëse.

### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MPJ në 2016 ishin në vlerë 2,546,086€.

Ne i kemi i testuar mostrat sa i përket arkëtimit të të hyrave dhe kemi evidentuar mangësitë e shpalosura në vijim:

---

#### Çështja 6 - Vonesat në regjistrimin e të hyrave - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Rregulla financiare 03/2010 kërkon që të hyrat të regjistrohen në SIMFK në baza ditore. Megjithatë, për shkak se të gjitha të hyrat arkëtohen jashtë vendit, MPJ kishte nxjerrë rregullore të brendshme ku kërkohet që të hyrat të raportohen dhe regjistrohen deri me datën 15 të muajit vijues.

Nga mostrat e testuara, tek të gjitha MDK-të janë vërejtur vonesa në regjistrimin e të hyrave deri në 53 ditë.

Kjo kishte ardhur si rezultat i mungesës së stafit të mjaftueshëm në MPJ, ku vetëm një zyrtar ishte ngarkuar me kontrollimin dhe regjistrimin e të hyrave të të gjitha MDK-ve. Sekretari i Përgjithshëm kishte dërguar kërkesë për lejimin buxhetit për këtë pozitë në MF, por ende nuk kishte marrë përgjigje.

**Rreziku** Informacioni në kohë dhe i saktë mbi të hyrat ekzistuese nuk është në dispozicion në kohën e duhur për të mbështetur vendimmarrjen e menaxhmentit. Vonesat në raportim pamundësojnë kryerjen e barazimeve mujore me Thesarin, dhe rrisin rrezikun e mos përfshirjes së tyre në PFV në fund të vitit.

**Rekomandimi 6** Ministri duhet të negociojë edhe më tutje me MF-në dhe MAP-in për lejimin e rekrutimit të stafit i cili do të ndihmonte në kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve në kohën e duhur.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes sistemit të centralizuar (payrollit). Kontrollat kyçe që operojnë nga MPJ kanë të bëjnë me llogaritjen e pagave në pajtim me kontratat e punës si dhe me legjislacionin e aplikueshëm. Numri i aprovuar i të punësuarve në MPJ së bashku me MDK-të ishte 275, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 262.

Numri i aprovuar për MDK-të ishte 127, ndërsa numri aktual ishte 139. Rritja e tyre mbi buxhetin e aprovuar ishte si rezultat i rritjes së numrit të misioneve të reja.

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 5,768,977€ i cili ishte shpenzuar pothuajse 100%. Ne, kemi rishikuar listat e pagave si dhe krahasuar të dhënat e prezantuara nga thesari, SIMFK dhe prezantimi i tyre në PFV. Po ashtu testuam mostra, duke përfshirë edhe dosjet e personelit.

#### Çështja 7 - Mangësi në menaxhimin e personelit- Prioritet i mesëm

**E gjetura** Rregullorja nr. 06/2012 për emërimet në shërbimin civil përcakton se asnjë pozitë e lartë drejtuese nuk mund të mbahet me Ushtrues Detyre (UD) më tepër se tre (3) muaj. Gjatë auditimit kemi vërejtur se një (1) pozitë menaxhuese mbahej me UD prej muajit korrik 2015. Sekretari i Përgjithshëm kishte dërguar kërkesë për lejimin buxhetit për këtë pozitë mirëpo kërkesa ishte refuzuar nga MF.

**Rreziku** Mbajtja e pozitës me ushtrues detyre më tepër se tre muaj mund të ndikojë në rënien e cilësisë së punës dhe në performancën e organizatës në përgjithësi.

**Rekomandimi 7** Ministri duhet të negociojë me MF-në, dhe të shikojë mundësitë që të ndahet buxheti për paga konform numrit të aprovuar të punëtorëve, në mënyrë që të krijohet mundësia për hapjen e procedurave të rekrutimit.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 12,684,559€ me një përqindje të shpenzimit prej 95%. Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve kryesisht kanë të bëjnë me shpenzimet e MDK-ve.

Për të vlerësuar procesin e prokurimit si dhe rregullsinë e pagesave, ne kemi testuar pagesat e kryera nga kjo kategori si dhe procedurat e zhvilluara të prokurimit.

Nga testimi i procedurave të prokurimit kemi vërejtur se kontrollet në fushën e prokurimit kanë funksionuar mirë dhe nuk kemi hasur në ndonjë parregullsi. Megjithatë, sa i përket testimit substancial kemi vërejtur mangësitë në vijim:

#### Çështja 8 - Vonesa në regjistrimin e shpenzimeve - Prioritet i mesëm

**E gjetura** UA nr. 05/2012 Neni 8 pika 2 specifikon se MDK-të deri me datën 15 të muajit pasues dërgojnë raport të shpenzimeve në departamentin e financave në MPJ, për t'i regjistruar në SIMFK.

Gjatë testeve tona kemi vërejtur se, MDK-ja në Berlin kishte raportuar shpenzimet e muajit shkurt, mars dhe prill me kohë në vlerë prej 94,748€, ndërsa MPJ i kishte regjistruar në SIMFK në shtator, me vonesë mbi pesë (5) muaj. Një situatë të ngjashme e kemi edhe me MDK-në në Frankfurt ku shpenzimet e muajit maj në vlerë 22,733€ ishin regjistruar në muajin shtator. Po ashtu, shpenzimet e MDK-së në Londër në vlerë 28,986€ të muajit qershor ishin regjistruar në shtator. Gjatë diskutimeve u informuam se këto mangësi ishin rezultat i mungesës së stafit në MPJ, sidomos duke marrë parasysh numrin e MDK-ve në rritje.

**Rreziku** Vonesat në regjistrim të shpenzimeve ndikojnë në nënvlerësim të shpenzimeve reale, të cilat vështirësojnë barazimet tremujore meqenëse SIMFK nuk jep një gjendje të saktë të tyre. Kjo po ashtu rritë rrezikun që në PFV të mos përfshihen të gjitha shpenzimet e ndodhura gjatë vitit.

**Rekomandimi 8** Ministri duhet të sigurojë se janë shtuar masat e kontrollit, përfshirë edhe numrin e stafit shtesë, në mënyrë që të gjitha regjistrimet në SIMFK të bëhen brenda afatit të përcaktuar kohor.

**Çështja 9 - Pagesa e qirasë pas kryerjes së misionit të konsullit - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Ambasada në Bernë kishte paguar shpenzimet e qirasë deri në muajin shtator 2016 në vlerë prej 14,166€<sup>3</sup> për banesën e cila kishte qenë në shfrytëzim të konsullit i cili kishte shërbyer deri më 30 nëntor 2015. Sipas zyrtareve të MDK-ve, pagesa e qirasë ishte bërë për ruajtjen e saj për të emëruarit e rinj. Megjithatë, askush nga diplomatët e rinj nuk kishte pranuar të akomodohej në këtë banesë.

**Rreziku** Pagesa e shpenzimeve të qirasë pa u shfrytëzuar nga MDK-të është keqpërdorim i parasë publike si dhe ndikon në rritjen e shpenzimeve pa e përfituar kundërvlerën e tyre.

**Rekomandimi 9** Ministri duhet të sigurojë kontrolle efikase në menaxhimin e parasë publike nga MDK-të. Pagesat të realizohen vetëm për mallrat apo shërbimet e përfituara. Në rastet e ndërprerjes së përfitimit të shërbimeve të ndërpriten kontratat.

**Çështja 10 - Tejkalmimi i limiteve të caktuara për paranë e imët - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** UA nr.03/2012 për shpenzimet operationale të MDK-së neni 14 autorizon MDK-të të mbajnë para të imët në vlerë deri në 500€, të cilat i raporton përmes raportit mujor.

Ne kemi vërejtur se Ambasada në Bernë dhe ajo në Romë kishte mbushur arkën e parave të imëta deri në 2,400€ brenda muajit. Gjatë vitit 2016, MDK në Bernë kishte shpenzuar nga arka 23,013€, përderisa Ambasada në Romë kishte shpenzuar 11,208€.

**Rreziku** Tejkalmimi i limiteve të përcaktuara, paraqet pagesa të parregullta të cilat e dëmtojnë buxhetin e MDK-ve, si dhe numri i madhe i pagesave mund t'i shmangën kontrolleve për aprovimin e tyre.

**Rekomandimi 10** Ministri duhet të sigurojë kontrolle në menaxhimin e parasë së imët nga MDK-të. Pagesat duhet të lejohen në përputhje me kornizën ligjore, si dhe të mos tejkalojnë limitet e përcaktuara.

<sup>3</sup> Vlera e paguar kishte qenë 17,000 CHF.

### 3.1.4 Subvencionet dhe Transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 364,547€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 364,470€, ose afro 100%. Shpenzimet në këtë kategori ishin bërë kryesisht për organizimin e konferencave që kanë të bëjnë me promovimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Gjatë testimeve kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

#### Çështja 11 – Mosplotësimi me dokumentacion të nevojshëm për subvencione - Prioritet i lartë

**E gjetura** Rregulla financiare 01/2013 neni 36, pika 4, specifikon se çdo subvencion i dhënë duhet të bazohet në një marrëveshje zyrtare mbi formën e subvencionimit.

MPJ kishte ekzekutuar pagesën e subvencionit në vlerë prej 300,000€ me vendim të Qeverisë, pa përgatitur një marrëveshje formale me përfituesin, në të cilën do të specifikoheshin kushtet e subvencionit. Përfituesi kishte sjellë raportet financiare mbi këtë subvencion vetëm në kohën kur ne ishim në auditim. Kjo kishte ardhur si rezultat i vendimit i cili ishte emergjent për t'u ekzekutuar.

Në një rast tjetër MPJ përmes një marrëveshje bashkëpunimi kishte subvencionuar një grup gazetarësh në vlerë 2,070€, për qëllim të promovimit të sportit Kosovar nëpër Evropë. Në pajtim me marrëveshjen përfituesi duhej të raportoj në MPJ lidhur me implementimin e projektit brenda periudhës tre mujore nga data e pagesës. Megjithatë, edhe pse kishte kaluar afati kohor i paraparë me marrëveshje, përfituesi ende nuk kishte ofruar dëshmi (raport financiar) lidhur me implementimin e projektit. Lidhur me këtë MPJ nuk kishte marrë masa siç parashihet me marrëveshje.

**Rreziku** Pagesa e subvencioneve pa nënshkrim të marrëveshjes paraprake, ndikon në menaxhimin jo të mirë të subvencioneve dhe rrit rrezikun që paratë publike të keqpërdoren. Po ashtu, mos raportimi lidhur me implementimin e projektit nga përfituesi rrit rrezikun që mjetet e dhëna të mos shfrytëzohen për qëllimin fillestar për të cilin janë dedikuar.

**Rekomandimi 11** Ministri duhet të sigurojë, se çdo pagesë të subvencioneve nga kodi buxhetor i MPJ-së i paraprinë një marrëveshje me kushte dhe specifika përkatëse. Po ashtu, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm duhet të sigurojnë se në rastet e mos respektimit të marrëveshjeve nga përfituesit, merren masat e përcaktuara me marrëveshje.

---

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 756,564€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 621,220€ apo 82%. Shpenzimet për investime kapitale kanë të bëjnë me blerjen e pasurive për ministrinë dhe MDK-të. Pjesën më të madhe e përbënin pagesat e mbetura nga periudhat e kaluara për projektin e sistemit të vizave.

---

#### Çështja 12 – Dobësi në vlerësimin e tenderëve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në procedurën e prokurimit “Furnizim me mobilje” në vlerë prej 7,138€, një ndër kriteret e kërkuara ishte dëshmia se Operatori Ekonomik (OE) kishte kryer furnizime të njëjta në tri (3) vitet e fundit. Fituesi i tenderit nuk kishte plotësuar këtë kriter për tri (3) vitet e fundit, mirëpo kishte sjellë dëshmi për furnizim të cilat ishin më të vjetra se periudha e kërkuar.
- Rreziku** Mos zbatimi i drejtë i rregullave dhe udhëzuesve të prokurimit publik mund të rezultojë në përzgjedhjen e ofertuesve të papërgjegjshëm, shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të tenderuesve dhe vlerë të dobët për para në praktikën e prokurimit.
- Rekomandimi 12** Ministri duhet të sigurojë se ushtrohen kontrole të mjaftueshme në mënyrë që të shpërblehet me kontratë vetëm OE të cilët i plotësojnë kërkesat në dosjen e tenderit.

## 3.2 Pasuritë

### 3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuritë neto të MPJ-së ishin 4,372,873€. Sipas regjistrimit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1000€) ishte 3,268,251€, vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) ishte 1,033,131€, si dhe vlera e stoqeve ishte 71,491€.

Auditimi jonë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi çështjet në vijim:

#### Çështja 13 - Dobësi në menaxhimin e depos - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Neni 8, pika 4, e rregullës financiare për menaxhimin e pasurisë specifikon se çdo pasuri duhet të pranohet në depo nga ana e komisionit të pranimi. Gjatë testimit të pagesës "Furnizim me toner" vërejtëm se pranimi i mallit në vlerë prej 1,855€ ishte bërë pa komision të pranimi.
- Rreziku** Pranimi i pasurive jo-financiare pa u verifikuar nga komisioni i pranimi, rritë rrezikun që pasuritë e pranuar të jenë jashtë kushteve të kontraktuara, sa i përket cilësisë dhe sasisë së tyre.
- Rekomandimi 13** Ministri duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë në MPJ pranohen përmes komisionit të pranimi. Në rast nevojë zyrtarëve përgjegjës t'ju ofrohen trajnimet e nevojshme lidhur me rregulloret për menaxhimin e pasurisë.

## 3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 47,686€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

#### Çështja 14 - Vonesë në pagesën e obligimeve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas LMFPP neni 29, çdo faturë duhet të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimi të faturës. Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se obligimi i muajit korrik për shpenzimet e furnizimit për zyre në vlerë 1,855€ ishte paguar 18 ditë pas afatit kohor ligjor, si dhe nuk ishte raportuar në MF/Thesar në raportin për obligime të muajit korrik.
- Rreziku** Mos pagesa në kohë e borxheve mund të rezultojë me ndëshkime ndaj ministrisë, ndërsa raportimi i mangët i obligimeve pamundëson planifikimin afatshkurtër të tyre.
- Rekomandimi 14** Ministri duhet të sigurojë se obligimet ndaj furnitorëve paguhet brenda afatit ligjor në mënyrë që të shmangët ekzekutimi i pagesave drejtpërdrejtë nga thesari. Nëse për ndonjë arsye obligimet mbesin të papaguara, ato duhet të raportohen në Thesar.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.



---

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Pasqyrat Financiare	Ministri duhet t'i kushtoj rëndësi të veçantë procesit të barazimit në lidhje me regjistrimin e shpenzimeve dhe duhet që këtë proces ta monitorojë dhe shtyjë përpara për të përfunduar sa më parë. Ne inkurajojmë menaxhmentin për diskutimin me MF për mbylljen e këtij procesi që do të reflektojë edhe në buxhetin e MPJ-së për vitet në vijim.		Ministria kishte avancuar në këtë proces, meqenëse zyrtari i barazimeve kishte evidentuar një pjesë të këtyre shpenzimeve dhe ishte përgatitur një raport për një pjesë në fund të vitit.	
Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të sigurojë që përgatitja e PVF-ve për vitin 2016 të përfshijë rishikimin e hollësishëm të draft pasqyrave nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në harmonizimin e shënimeve dhe në fushat që konsiderohen që janë të rrezikut të lartë. Deklarata e nënshkruar nga ZKA dhe ZKF nuk duhet vendosur derisa kontrollet e nevojshme janë aplikuar.		Në PVF e vitit aktual nuk janë evidentuar gabime, megjithatë edhe këtë vit nuk ishin përfshirë pasuritë e blera gjatë vitit, si dhe softueri nga viti i kaluar.	
Te hyrat	Ministri duhet të sigurojë se kontrollet janë efektive dhe kërkesat e raportimit të jashtëm në lidhje me të hyrat (barazimi me Thesar) realizohet çdo muaj siç e parasheh rregullorja financiare për të hyrat.			Nuk janë marrë masa.
Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pa adresuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, me fokus fillestar në fushat e një rëndësie më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të monitorohet dhe ne presim që të ketë një progres mbi këtë.		Përkundër progresit në zbatimin e rekomandimeve të AP-së, mangësi të njëjta janë prezentë edhe këtë vit.	

Lista kontrolluese e vet-vlerësimit	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vet-vlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.			Nuk janë marrë masa.
Menaxhimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë përmes sekretarit të përgjithshëm se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut te një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë duke monitoruar se si rreziqet janë duke u menaxhuar.			Nuk janë marrë masa.
Auditimi i brendshëm	Ministri duhet të sigurojë se ekziston një komunikim i mirë në mes menaxhmentit, komitetit të auditimit dhe NjAB-së për të identifikuar mangësitë e kontrolleve të brendshme, dhe auditimet të orientohen në fushat ku rreziku nga mangësitë është më i madh. Po ashtu duhet të ndërmerren veprime që rekomandimet e AB të gjejnë zbatim në praktikë, e këtu një rol kyç e ka komiteti i auditimit në monitorimin dhe shtyrjen e këtij procesi.			Nuk janë marrë masa.
Buxheti	Ministri, duhet të sigurojë se është bërë një vlerësim i arsyeve në lidhje me nevojën e ndryshimeve të shpeshta të buxhetit. Po ashtu, duhet siguruar se përgatitja e buxhetit paraprihet nga një analizë e detajuar e cila pasqyron në mënyrë të plotë informatat përfshirë shpenzimet e vitit të kaluar/ndryshimet e pritura të vitit, etj. Performanca e buxhetit duhet të monitorohet dhe të adresohen barrierat e identifikuar në ekzekutimin e niveleve të planifikuara të buxhetit.	Po		

Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit një bashkëpunim efektiv të njësive të kërkesave me departamentin e prokurimit në procesin e planifikimit. Kjo duhet të bëhet duke planifikuar me kohë dhe duke e ndërlidhur planin e prokurimit me buxhetin e ndarë. Zhvillimi i procedurave të hapura mundëson një konkurrence të mirëfilltë, dhe shpenzime më ekonomike.	Po		
Monitorimi i projektit	Ministri duhet të sigurohet para se të kryhen pagesat e mbetura, nëse projekti ishte realizuar në përputhje të plotë me marrëveshjen. Kjo mund të bëhet duke formuar një komision të përbërë nga stafi profesional, i cili do të verifikonte shkallën e realizimit të projektit, dhe pas pranimit të raportit të komisionit të vazhdohet me pagesën e obligimeve të mbetura.		Ministria e kishte paraparë këtë projekt dhe kishte planifikuar dhe ekzekutuar nga Investimet kapitale, raportet përsëri nuk përmbanin informata të detajuara.	
Pagesat për paga nga kategoria mallra	Ministri duhet të sigurojë se fondet po shfrytëzohen në përputhje me legjislacionin dhe për qëllime të dedikuara me buxhetin.	Po		
Misionet Diplomatike	Ministri duhet të sigurojë te MDK-të që kanë valutë jo Euro që çështja e kursit të këmbimit të aplikohet sipas një kriteri dhe regjistrimi i shpenzimeve dhe të hyrave të jetë i barazuar plotësisht. Kjo do të ndikonte që shpenzimet dhe të hyrat të jenë reale dhe të mos ketë mbivlerësim dhe as nënvlerësim.		MPJ gjatë vitit 2016 kishte bërë përpjekje që sa më shumë të i përafrojë regjistrimet me MDK të cilat kanë valutë jo-Euro.	
Misionet Diplomatike	Ministri duhet të sigurojë se janë shtuar masat e kontrolleve për t'i eliminuar vonesat në regjistrimin e shpenzimeve nga zyrtarët e shpenzimeve në ministri. Në rastet kur ka diferenca të shpenzimeve të cilat sipas zyrtarëve nuk mund të regjistrohen, atëherë duhet të kërkohen dokumente apo sqarime shtesë nga MDK-të përkatëse.			Nuk janë marrë masa.

Paga dhe mëditje	Ministri duhet të sigurojë se kriteret specifike për gradime dhe emërime të nëpunësve për shërbimin e jashtëm aplikohen në të gjitha rastet. Po ashtu, duhet të sigurojë respektimin e afatit për kontratat mbi vepër si dhe për u.d. siç e parasheh legjislacioni duke siguruar rekrutim të stafit me kohë.		Edhe këtë vit vazhdonte të mbahej një pozitë me U.D përtej afatit ligjor, megjithatë ne nuk evidentuam ndonjë rast të gradimit si dhe kontratave mbi vepër jashtë kërkesave ligjore.	
Subvencione dhe transfere	Ministri duhet të sigurojë se dhënia e subvencioneve monitorohet përmes raporteve narrative dhe financiare, në mënyrë që menaxhmenti të sigurohet që mjetet janë shpenzuar sipas kërkesës së paraqitur në projekt propozim.		Gjatë vitit nuk evidentuam ndonjë projekt i cili nuk ka sjellë tashmë raport, megjithatë vonesat ishin mjaft të theksuara në raportim.	
Te hyrat	Ministri duhet të rrisë nivelin e përgjegjësisë nga shefat e misioneve diplomatike për të shmangur vonesat dhe të sigurojë që të gjitha të hyrat raportohen dhe regjistrohen me kohë në SIMFK.			Nuk janë marrë masa.
Pasuritë	Ministri duhet të shtoj kontrollin në menaxhimin e pasurive duke siguruar regjistrim dhe raportim të saktë, të plotë si dhe me kohë të vlerës së pasurisë që disponon MPJ. Po ashtu, inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë të bëhet në pajtim të plotë me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 02/2013.			Nuk janë marrë masa.
Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë që ZKA ka ndërmarr veprimet efektive për të forcuar kontrollin në menaxhimin e depos dhe automjeteve. Çdo artikull duhet të pranohet nga zyrtari i pranimit (depoisti) ose komisioni i pranimit në rastet e caktuara. Po ashtu, Ministri duhet të sigurojë se janë aplikuar kontrole efektive për të parandaluar përdorimin e automjeteve jashtë orarit pa aprovimin paraprak. Kjo do të ndikojë në përdorimin e rregullt dhe efikas të automjeteve		Ne kemi vërejtur se edhe në vitin 2016 ishin pranuar pasuri pa komisione. Sa i përket shfrytëzimit të veturave në testet tona nuk ishte hasur ndonjë mangësi.	

---

Obligimet	Ministri duhet të sigurojë se është vendosur një sistem efikas ku faturat pranohen dhe evidentohen në një vend dhe pastaj bëhet shpërndarja për zyrtarët përkatës. Kjo praktikë do të mundësojë që raportimi i obligimeve të jetë i saktë dhe i plotë dhe jep informata të plota për menaxhmentin dhe palët tjera për obligimet aktuale. Po ashtu në raportimet mujore duhet të përcjellët kronologjia e faturave të papaguara në mënyrë që faturat e papaguara të raportohen deri sa të paguhen dhe që menaxhmenti dhe Thesari të kenë informacionin e saktë për obligimet e mbetura.			Nuk janë marrë masa.
-----------	--	--	--	----------------------



## Shtojca IV: Letërkonfirmimi



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Punëve të Jashtme / Ministarstvo Inostranih Poslova / Ministry of Foreign Affairs*

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Fitim Sadiku.....

Sekretar i Përgjithshëm

02.06.2017